

Faith: A Bond of Trust and Loyalty

By Elder Sandino Roman
Of the Seventy

Besimi: Një Lidhje Mirëbesimi dhe Besnikërie

Nga Plaku Sandino Roman,
i Të Shtatëdhjetëve

April 2025 general conference

Faith sprouts as we trust in Jesus Christ and blooms as we are faithful and loyal to Him.

When I was 17, I made an agreement with my friend José Luis to teach him how to swim. So one morning we dedicated time to practice. When our lesson was over and I was leaving the pool, I heard my friend shouting for help. He was drowning in the deep end of the pool.

I threw myself into the water and swam toward him while praying for help. As I grabbed his hand to pull him to the surface, my desperate friend climbed onto my back and put me in a choke hold. Now we were both drowning. Trying my best to reach the surface, I prayed with all my might for a miracle from God. Then, slowly but steadily, the power of God was manifest as I felt a hand propelling me toward the shallow end of the pool, bringing us to safety.

This experience confirmed a profound lesson President Russell M. Nelson once taught: “When you reach up for the Lord’s power in your life with the same intensity that a drowning person has when grasping and gasping for air, power from Jesus Christ will be yours.”

Dear children and young people, today I want to talk to you about the essential principle of faith in Jesus Christ.

Faith in Christ Means Trusting Him

What does it mean to have faith in Christ? Does it mean we believe in Him or have a testi-

Besimi mbin ndërsa i mirëbesojmë Jezu Krishtit dhe lulëzon kur jemi besimplotë dhe besnikë ndaj Tij.

Kur isha 17 vjeç, bëra një marrëveshje me mikun tim Hoze-Luisin për t’i mësuar notin. Kështu që një mëngjes gjetëm kohë për t’u ushtruar. Kur mësimi ynë mbaroi dhe po largohesha nga pishina, e dëgjova shokun tim duke bërtitur për ndihmë. Ai po mbytej në skajin e thellë të pishinës.

U hodha në ujë dhe notova drejt tij ndërkohë që lutesha për ndihmë. Ndërsa e kapa nga dora për ta nxjerrë në sipërfaqe, miku im i dëshpëruar më hipi në kurriz dhe më shtrëngoi në fyt. Tani po mbyteshim të dy. Në përpjekje për të dalë në sipërfaqe, u luta me gjithë forcën time për një mrekulli nga Perëndia. Atëherë, ngadalë por në mënyrë të qëndrueshme, fuqia e Perëndisë u shfaq teksa ndjeva një dorë të më shtynte drejt skajit të cekët të pishinës, duke na çuar drejt sigurisë.

Kjo përvojë pohoi një mësim të thellë që e dha mësim dikur Presidenti Rasëll M. Nelson: “Kur ju zgjateni për [ta marrë] fuqinë e Zotit në jetën tuaj me të njëjtin intensitet që ka një njeri që po mbytet, kur kapet dhe gulçon për ajër, fuqi nga Jezu Krishti do të je[n]ë tuaja[t].”

Të dashur fëmijë dhe të rinj e të reja, sot dua t’ju flas për parimin thelbësor të besimit te Jezu Krishti.

[Të Kesh] Besim te Krishti do të Thotë t’i Mirëbesojmë Atij

Çfarë do të thotë të kemi besim te Krishti? A do të thotë që besojmë tek Ai apo që kemi një

mony that He is real? That may be a start, but it's more than that. Have you ever thought of faith astrust? Think of the person you trust the most—perhaps a family member or a friend. Why do you trust them? It is probably because you have seen their constant love and help.

When we have faith in Christ, we recognize His blessings and develop a relationship of trust with Him.

In a recent youth devotional, you were invited to meditate on a time in your life when you received a ray of heavenly light. Try this exercise!

Start by meditating about Christ and the happiness His Atonement and gospel bring to your life. Also, make a record of the “spiritually defining memories” where God has been there for you, for your loved ones, and for the people in the scriptures. Now, these testimonies will not bring power to your life until the Spirit etches them in the “fleshy tables” of your heart. So ponder and record all God set in motion for these miracles to come at just the right time.

Next, use this exercise as an opportunity to get closer to God. Pray to your Heavenly Father as if it were the first time. Express your love and gratitude for His blessings. Even ask Him how He feels about you and about the direction your life is taking.

If you are sincere and humble, you will hear His answer and begin a personal and lasting relationship with Heavenly Father and Jesus Christ. Not only that, but your religious habits will become meaningful! For instance, you will look forward to your prayers, personal study, and temple worship as opportunities to get to know Them and be with Them.

Faith Flourishes with Loyalty

Notice that faith sprouts as we trust in Jesus Christ and blooms as we are faithful and loyal to Him. If you want a true relationship with Christ, show Him by making covenants and honoring them with faithfulness and loyalty. Making covenants with Jesus Christ builds hope. Honoring them builds faith.

dëshmi që Ai është i vërtetë? Ky mund të jetë një fillim, por është më shumë sesa kaq. A keni menduar ndonjëherë për besimin simirëbesim? Mendoni për njeriun të cilit i mirëbesoni më tepër, ndoshta një pjesëtar të familjes apo një mik. Përse i mirëbesoni këtij njeriu? Ka gjasë ngaqë keni parë dashurinë dhe ndihmën e tij të vazhdueshme.

Kur kemi besim te Krishti, ne i dallojmë bekimet e Tij dhe zhvillojmë një marrëdhënie mirëbesimi me Të.

Në një takim shpirtëror për rininë të kohëve të fundit, ju u ftuat të meditoni për një rast në jetën tuaj kur morët një rreze drite qiellore. Provojeni këtë ushtrim.

Filloni duke medituar rreth Krishtit dhe lumturisë që Shlyerja dhe ungjilli i Tij sjellin në jetën tuaj. Gjithashtu, bëni një anal të “kujtimit [ve] që [ju] përcaktojnë shpirtërisht”, ku Perëndia ju është gjendur pranë juve, njerëzve tuaj të dashur dhe njerëzve në shkrimet e shenjta. Tani, këto dëshmi nuk do të sjellin fuqi në jetën tuaj derisa Shpirti t'i gdhendë në “rrasa[t] ... [prej] mi-shi” të zemrës suaj. Pra, përsiateni dhe mbajeni shënim gjithçka që Perëndia vuri në lëvizje, që këto mrekulli të ndodhnin pikërisht në kohën e duhur.

Më pas, përdoreni këtë ushtrim si një mundësi për t'u afruar më shumë me Perëndinë. Lutjuni Atit tuaj Qiellor sikur të ishte hera e parë. Shprehni dashurinë dhe mirënjohjen tuaj për bekimet e Tij. Madje, pyeteni Atë se çfarë ndien për ju dhe për drejtimin që po merr jeta juaj.

Nëse jeni të çiltër dhe të përlulur, do ta dëgjoni përgjigjen e Tij dhe do të nisni një marrëdhënie vetjake dhe të qëndrueshme me Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin. Jo vetëm kaq, por edhe zakonet tuaja fetare do të bëhen kuptimplota! Për shembull, ju do t'i prisni me padurim lutjet tuaja, studimin vetjak dhe adhurimin në tempull si mundësi për t'i njohur Ata dhe për të qenë me Ta.

Besimi Lulëzon me Besnikërinë

Vini re se besimi mbin ndërsa i mirëbesojmë Jezu Krishtit dhe lulëzon kur jemi besimplotë dhe besnikë ndaj Tij. Nëse doni një marrëdhënie të vërtetë me Krishtin, tregojani Atij këtë duke bërë besëlidhje dhe duke i nderuar ato plot besim dhe besnikëri. Bërja e besëlidhjeve me Jezu Krishtin ndërton shpresën. Nderimi i tyre ndërton besimin.

Let me use a personal example: When I was a child, I found my mother crying alone one day. When I asked her why, she gently said, “I need you to be a good boy.” Even though I knew that I was not the cause of her distress, I loved and trusted my mother like no one else and wanted to make her life less difficult. So, with tears in my eyes and with all the solemnity that a nine-year-old can have, I promised her that day I would always strive to be the best son and make her proud.

Can you imagine the power that promise had—and still has—on me?

That promise with her would guide my life. Before making decisions, I would consider whether my actions would please her. The bond of this promise and the relationship with my mother were the anchors for my conduct throughout my life.

Years later, as I came to know Jesus Christ better, I already knew how to base my faith in Him. I made covenants with the Lord, and as I have sought to honor them, He has forgiven my sins, guided my life, and “filled me with his love” to the very core of my being. Christ has instilled in me a deep love, respect, and loyalty for Him.

Do you understand why “faith is a principle of action” and that “without faith it is impossible to please [God]”?

As you try to do what pleases Him, you will say, like Joseph in Egypt when he was tempted by Potiphar’s wife, “How then can I do this great wickedness, and sin against God?” And when faced with opposition, you will say, like the young Prophet Joseph, “I knew it, and I knew that God knew it, and I could not deny it; ... I knew that by so doing I would offend God.”

So faith in Jesus Christ is a bond of trust forged in loyalty and love. In other words, in gratitude for God’s merciful love (hesed), we show our loyal love (emunah) by keeping His commandments.

Christ promises, “He that hath my commandments, and keepeth them ... shall be loved of my Father, and I will love him, and will manifest myself to him.” If you commit to being loyal to Him, He will manifest His love for you.

Më lejoni të përdor një shembull vetjak: Kur isha fëmijë, një ditë e gjeta nënën time duke qarë vetëm. Kur e pyeta për arsyen, ajo me butësi tha: “Kam nevojë që të jesh një djalë i mirë”. Edhe pse e dija se nuk isha unë shkak i shqetësimit të saj, e doja dhe i mirëbesoja nënën si askujt tjetër dhe doja që t’ia bëja jetën më të lehtë. Ndaj, me lot në sy dhe me gjithë seriozitetin që mund të ketë një nëntëvjeçar, i premtova atë ditë se do të përpique-sha gjithmonë të isha djali më i mirë i mundshëm dhe ta bëja atë krenare.

A mund ta përfytyroni fuqinë që ai premtim pati dhe ka ende tek unë?

Ai premtim që i bëra asaj, më udhërrëfeu jetën. Para se të merrja vendime, shqyrtoja me veten a do të kënaqej ajo nga veprimet e mia. Lidhja pas atij premtimi dhe marrëdhënia me nënën time qenë spirancat e sjelljes sime gjatë gjithë jetës.

Vite më vonë, kur arrita ta njihja më mirë Jezu Krishtin, tashmë dija se si ta bazoja besimin tim tek Ai. Bëra besëlidhje me Zotin dhe, ndërsa jam përpjekur t’i respektoj ato, Ai m’i ka falur mëkatet, ma ka udhërrëfyer jetën dhe “më ka mbushur me dashurinë e Tij” deri në pjesën më të thellë të qenies sime. Krishti më ka rrënjësuar një dashuri, respekt dhe besnikëri të thellë për Të.

A e kuptoni pse “besimi është një parim veprimi” dhe se “pa besim është e pamundur t’i pëlqesh [Perëndisë]”?

Teksa përpiqeni të bëni atë që i pëlqen Atij, ju do të thoni ashtu si Jozefi në Egjipt kur u tundua nga gruaja e Potifarit: “Si mund ta bëj unë këtë të keqe të madhe dhe të kryej një mëkat kundër Perëndisë?” Dhe kur përballeni me kundërshtim, ju do të thoni ashtu si profeti i ri Jozefi: “Unë e dija atë dhe e dija se Perëndia e dinte atë dhe nuk mund ta mohoj ... e dija se duke e bërë këtë, do ta fyeja Perëndinë”.

Pra, besimi te Jezu Krishti është një lidhje mirëbesimi e farkëtuar në besnikëri dhe dashuri. Me fjalë të tjera, në mirënjohje për dashurinë e mëshirshme të Perëndisë (hesed-in), ne tregojmë dashurinë tonë besnike (emunah-un) duke i zbatuar urdhërimet e Tij.

Krishti premton: “Kush ka urdhërimet e mia dhe i zbaton, është ai që më do; dhe kush më do mua, Ati im do ta dojë; dhe unë do ta dua dhe do t’i dëftohem atij”. Nëse zotoheni për të qenë besnikë ndaj Tij, Ai do t’jua dëftejë juve dashurinë e Tij.

Faith in the Face of Adversity

But how should you respond to such adverse situations that require His miracles? While challenges are inevitable and sometimes frightening, simply walk undaunted toward Him, just as the 2025 FSY conference theme invites: “Look unto me in every thought; doubt not, fear not.”

Imagine that you are an explorer in uncharted territory. To overcome the obstacles ahead, you need a source of light. Your faithfulness to God and your constant interactions with Him are the fuel for your lantern. So when you encounter dark and perilous situations, instead of walking toward them blindly, you will turn on your lamp filled with the oil of faith in Christ to shed glimmers of hope on the uncertain path. Your past experiences will increase your hope that the Lord will sustain you on your journey.

Remember my story at the pool? In that moment of despair, the miracle came in the way I had expected, but God does not guarantee that it will always be according to our will. Our faith must be centered in Christ and our hope in His blessings, as He chooses to send them. “Expect miracles,” but “let God prevail in our lives.”

God's Promises to His Faithful People

My young friends, how much we love and trust you! You belong to the family of God and are children of the covenant. Believe and trust in Jesus Christ. He will enable you to truly become His disciples.

I invite you to begin today to nurture your relationship with Jesus Christ. Make a commitment to never forsake Him.

Your loyalty, love, and trust in Christ will shape your character and identity after His. You will gain confidence and strength to overcome Satan's attacks. And when you make mistakes, you will yearn for His forgiveness. Finally, your hope for the future will be bright. He will trust you with His power to accomplish anything He expects of you, even the power to return to His presence.

Besim Përballë Fatkeqësisë

Por si duhet të reagoni ndaj situatave të tilla të pafavorshme që kërkojnë mrekulli prej Tij? Ndërsa sfidat janë të pashmangshme dhe ndonjëherë të frikshme, thjesht ecni pa u trembur drejt Tij, ashtu siç na fton tema e konferencës së FSY-së për vitin 2025: “Shihni tek unë në çdo mendim; mos dyshoni, mos kini frikë”.

Përfytyroni sikur jeni një hulumtues në një territor të pahulumtuar. Për t'i kapërcyer pengesat përpara jush, ju nevojitet një burim drite. Besnikëria juaj ndaj Perëndisë dhe ndërveprimet tuaja të vazhdueshme me Të janë si lënda djegëse për kandilin tuaj. Pra, kur hasni situata të errëta dhe të rrezikshme, në vend që të ecni verbërisht drejt tyre, ju do të ndizni llambën tuaj të mbushur me vajin e besimit të Krishti për të shpërndarë vezullime shprese në shtegun e pasigurt. Përvojat tuaja të kaluara do t'ju shtojnë shpresën se Zoti do t'ju mbështetë në rrugëtimin tuaj.

A ju kujtohet historia ime në pishinë? Në atë çast dëshpërimi, mrekullia erdhi ashtu siç e kisha pritur, por Perëndia nuk garanton se do të bëhet gjithmonë sipas vullnetit tonë. Besimi ynë duhet të përqendrohet te Krishti dhe shpresa jonë te bekimet e Tij, ashtu siç Ai zgjedh t'i dërgojë ato. “Prisni mrekulli”, por “lejo[je]ni Perëndinë të triumfojë në jetën tuaj”.

Premtimet e Perëndisë për Popullin e Tij Besimplotë

Miq të mi në moshë të re, sa shumë ju duam dhe ju mirëbesojmë! Ju ipërkisnifamiljes së Perëndisë dhe jeni fëmijë të besëlidhjes. Besonite Jezu Krishti dhe mirëbesojini Atij. Ai do të bëjë të mundur që ju të bëhenime të vërtetë dishepujt e Tij.

Ju ftoj të filloni sot ta ushqeni marrëdhënien tuaj me Jezu Krishtin. Zotohuni të mos e braktisni kurrë Atë.

Besnikëria, dashuria dhe mirëbesimi juaj te Krishti do t'ju japin formë karakterit dhe identitetit tuaj sipas të Tijit. Do të fitoni vetëbesim dhe forcë për të mposhtur sulmet e Satanit. Dhe kur të bëni gabime, do të dëshironi me zjarr faljen e Tij. Përfundimisht, shpresa dhe e ardhmja juaj do të jenë të ndritura. Ai do t'ju mirëbesojë fuqinë e Tij për të përmbushur gjithçka që Ai pret prej jush, madje edhe fuqinë për t'ju kthyer në praninë e Tij.

I testify to you of the joy that comes from singing “the song of redeeming love” and being “encircled about eternally in the arms of his love.” In the sacred name of Jesus Christ, amen.

Ju dëshmoj për gëzimin që vjen nga të kënduarit e “këngë[s së] dashurisë shëlbuese” dhe të qenit të “rrethuar përjetësisht në krahët e dashurisë së tij”. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen.